

Gratë rurale shqiptare kërkojnë drejtësi për realizimin e aspiratave të tyre

Ne, pesëdhjetë pjesëmarrës, kryesisht gra dhe vajza nga komunitetet rurale të vendit, u takuam në bashkinë e Roskovecit më 15 tetor 2020 nën kujdesin e Kryetares së Bashkisë së Roskovecit dhe Koordinatorës Kombëtare të Rrjetit Shqiptar për Zhvillimin Rural dhe me mbështetjen e organizatave anëtare të Rrjetit. I jemi mirënjohës bashkisë së Roskovecit dhe stafit për mikpritjen dhe organizimin e eventit PRO GRAVE RURALE II me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Grave Rurale. Ne u mbledhëm dhe diskutuam nevojat dhe sfidat e shumta që përjetojmë dhe u konsultuam mbi gjetjen e zgjidhjeve praktike dhe se, në ç'mënyrë politikat dhe instrumentet publike mund të ofrojnë ndihmë dhe mbështetje.

Situata e pafavorshme sociale dhe ekonomike e grave dhe vajzave rurale është një shqetësim mbarëbotëror. Gratë dhe vajzat rurale në Shqipëri përfaqësojnë pjesën më vitale të zhvillimit bujqësor dhe rural dhe kontributi i tyre është i paçmueshëm. Gruaja rurale kontribuon dhe investon në mirëqenien e familjes, jetës komunitare dhe më gjerë edhe pse ky kontribut shpesh është i pavlerësuar dhe i papaguar. Në të vërtetë, gruaja rurale është e varfër, dhe në krahasim me burrat në zonat rurale dhe gratë në ato urbane është më e varfër. Ajo ka akses të ulët në shërbime publike bazë, infrastruktura, tregje, teknologji dhe informacion. Ka akses shumë më të ulët në pronësi dhe menaxhimin e fermës; është më pak e arsimuar dhe e papërfaqësuar në jetën sociale, ekonomike dhe politike.

Të ndërjegjshëm se zhvillimi i qëndrueshëm social dhe ekonomik i vendit nuk mund të arrihet nëse nuk u ofrohet mbështetje grave dhe vajzave në zonat rurale që të luftojnë varfërinë dhe përjashtimin social, këmbëngulim se përfshirja e fuqizimit social-ekonomik të tyre në agjendën e politikë-bërjes është prioritet;

Mikpritja dhe kujdesi që gratë e zonave rurale tradicionalisht kanë treguar për vizitorë, miq dhe të ftuar në komunitetet dhe familjet e tyre, përfshi këtu edhe përfaqësues të lartë të shtetit dhe institucioneve të vendit, reciprokisht kërkon vëmendjen e institucioneve përkatëse të sektorit për të pritur dhe dëgjuar grupe të organizuara të grave që artikulojnë nevojat dhe aspiratat e tyre, ofrojnë zgjidhje praktike dhe kërkojnë mbështetje;

Duke besuar në potencialin e dialogut publik si një komunikim me dy kahe që kontribuon në funksionimin e demokracisë vendore dhe qeverisjen e mirë, kalimi nga shkallët e ulëta të pjesëmarrjes qytetare në ato më të larta - nga informimi në konsultim dhe dialog - është vendimtar për të kuptuar sfidat reale të grave në komunitetet rurale dhe ofruar mbështetje efektive të bazuar në nevoja;

Skema kombëtare e mbështetjes së bujqësisë dhe zhvillimit rural si një nga instrumentet kryesore mbështetëse të sektorit, edhe pse me kufizimet e veta, duhet të ridimensionohet duke brendësuar çështjet gjinore në procesin e aplikimit. Aplikantet femra duhet të gëzojnë bonus gjinor pikësh me qëllim të ngushtimit të hendekut social dhe ekonomik. Kjo kërkon një rishikim tërësor të procesit të aplikimit për të tejkaluar mangësitë dhe garantuar drejtësinë e procesit.

GRUAJA RURALE VIZIONARE KËRKON MUNDËSITË PËR TË QËNË EDHE NËNË E MIRË, SIPËRMARRËSE E SUKSESSHME DHE GRUA AKTIVE NË KOMUNITET. AJO KA NEVOJË PËR TRAJTIM TË DREJTË.

**PRO
GRAVE
RURALE**